



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.18/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/2348/2025, të datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, dhe kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/2349/2025, të datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, të datës 06.09.2025, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 10.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

**REFUZOHET E PABAZUAR** ankesa ZL Anr.18/2025 datës 08.09.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën ka kërkuar që të obligoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, që të anuloj vendimin nr. Protokolli 01/2348/2025, të datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, dhe kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokolli 01/2349/2025, të datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, të datës 06.09.2025, dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të marrë një Vendim për miratimin e përbërjes së ekipeve të Numërimit në Qendrat e Numërimit Komunal dhe Vendimin për miratimin e përbërjes së Këshillave të vendvotimit në qendrat e votimit të rregullta dhe me kusht, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 për komisionet e votimit, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 08.09.2025 PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën thekson se me datën 7 shtator 2025, KQZ-ja mori dy

vendime: Vendimi nr. 01-2348/2025 i KQZ-së për miratimin e rekomandimit për përbërjen e këshillave të vendvotimeve, të rregullta dhe me kusht dhe Vendimin nr. 01-2349/2025 mbi miratimin e rekomandimit për përbërjen e ekipeve të numërimit në QKN. Subjekti politik Lista Serbe beson se KQZ-ja, duke miratuar Vendimin nr. 01-2349/2025 për miratimin e rekomandimit për përbërjen e ekipeve të numërimit në QKN, shkeli ligjin, pra nenet 63 dhe 64 dhe nenin 101 të Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, dhe nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit. Për më tepër, subjekti politik Lista Serbe, beson se KQZ-ja, duke miratuar Vendimin nr. 01-2348/2025 të KQZ-së për miratimin e rekomandimit për përbërjen e këshillave të vendvotimeve, të rregullta dhe me kusht, shkeli ligjin, d.m.th. nenet 63, 64 paragrafi 2.10, neni 77, neni 75, neni 76, neni 77 dhe neni 78 i Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, si dhe neni 3 i Rregullores Zgjedhore nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve. Subjekti politik Lista Serbe beson se përbërja e këtyre këshillave është e paligjshme dhe në kundërshtim me ligjin, dhe se disa subjekte politike favorizohen, ndërsa subjekti politik Lista Serbe diskriminohet sepse iu është caktuar një numër shumë më të vogël kryetarësh, anëtarësh dhe anëtarësh rezervë sesa KQZ-ja do të kishte qenë e detyruar t'ia caktonte sipas ligjit subjektit politik që fitoi më shumë vota të komunitetit serb në komunat si në vijim: Në komunën e Novo Brdo, Srpska lista ne 23 qendrave të votimit nuk ka asnjë kryesues të vetëm të këshillit, dhe nuk ka as edhe një anëtar në 9 qendra votimi, dhe në zgjedhjet parlamentare, Lista Serbe fitoi më shumë se 60% të votave. Secilin prej 6 kryetarëve në këtë komunë i ka Vetëvendosje me 16.91% të votave, PDK me 5.8% dhe LDK me 10.29% të votave. 5 kryetarë u fituan nga AAK me 1.78% votave. Në komunën e Leposaviqit, nga 25 qendra votimi, Lista Serbe ka kryetarë vetëm në 6, dhe ne fituam 68.7% të votave në zgjedhjet parlamentare. Në këtë komunë Vetëvendosja me 1.86% të votave të fituara i ka më shumë kryetaresh, dhe po aq kryetarë si ne i kanë të PDK-së me 0.36% të votave të fituara, si dhe "Për liri, drejtësi dhe mbijetesë" me 4.92% të votave, që është pothuajse 14 herë më pak se Lista Serbe. Në komunën e Shtërpçës, Lista Serbe ka kryetar në 2 nga 17 vendvotime, dhe në 6 vendvotime ne nuk kemi as kryetar dhe as anëtar dhe në zgjedhjet parlamentare fituam 60.6% të votave ose 3906. Në të njëjtën komunë Vetëvendosja ka 7 kryetarë dhe në zgjedhjet parlamentare fitoi 12.8% ose pesë herë më pak se Lista Serbe. PDK me 7.59% dhe LDK me 3.23% të votave të fituara kanë dy herë më shumë kryetarë se subjekti ynë politik. Dhe subjekti politik "Për liri, drejtësi dhe mbijetesë" është i barabartë me ne, i cili fitoi 9.56% ose 6 herë më pak vota se Lista Serbe në zgjedhjet parlamentare. Në komunën e Zubin Potokut, nga 15 vendvotime, Lista Serbe ka një kryetar në 2 nga 15 vendvotime, dhe në 4 qendra votimi nuk kemi as anëtar dhe as kryetar, dhe në zgjedhjet parlamentare fituam 2406 vota ose 66.37%. Nga ana tjetër, Vetëvendosja me 5.5% të votave të fituara ka 4 kryetarë, dyfish më shumë se Lista Serbe, si dhe PDK me 3.39% të votave të fituara. Në komunën e Zveçanit, nga 11 vendvotime, Lista Serbe ka vetëm 3 kryetarë, dhe në zgjedhjet parlamentare fituam 74.87% të votave. Po aq kryetarë ka edhe Vetëvendosja me 3.27% të votave të fituara dhe PDK-ja 2% të votave të fituara. Në komunën e Parteshit, nga 7 qendra votimi, kemi vetëm 1 kryetar, dhe në zgjedhjet parlamentare fituam 89.16% të votave. Duket e tmerrshme që nga 2 kryetarë secili, morën partitë Vetëvendosja me 0.26% të votave të fituara, si dhe PDK-ja dhe LDK-ja, të cilat nuk kishin asnjë votë në këtë komunë. Në komunën e Mitrovicës së Veriut, nga 22 qendra votimi, kemi kryetar vetëm në 3 qendra votimi dhe në

zgjedhjet parlamentare fituam 56.21% të votave. Numri i kryetarëve në këtë komunë që iu caktua Vetëvendosjes, e cila fitoi 13% në zgjedhjet parlamentare janë 6, dy herë më shumë kryetarë se Lista Serbe, dhe më shumë se 4 herë më pak vota. Është një fakt i frikshëm që partitë PDK me 4.29% të votave në zgjedhjet parlamentare dhe LDK me 0.79% të votave të fituara në zgjedhjet parlamentare morën nga 5 kryetarë secila. Dhe në vendvotimin me kusht, kryetari iu caktua Vetëvendosjes. Në komunën e Graçanicës, nga 34 qendra votimi, Lista Serbe ka vetëm 4 kryetarë dhe në 10 qendrat e votimit nuk kemi as anëtar dhe as kryetar edhe pse në zgjedhjet parlamentare fituam 68.51% të votave në këtë komunë, pra 6602 vota, ndërsa Vetëvendosja me 5.68%, PDK me 2.84% dhe LDK me 2.95% të votave të fituara morën nga 7 kryetar secila, dhe AAK me 0.49% të votave fitoi 6 kryetar. Në komunën e Pejës, nga 139 qendra votimi, nuk kemi kryetar dhe kemi vetëm 2 anëtarë të këshillit të vendvotimit. Në komunën e Klllokotit-Vërbovcit, nga 8 kryetarë, Lista Serbe ka vetëm 2 kryetarë, dhe në zgjedhjet parlamentare fituam 49.12% të votave. Lista Serbe nuk ka asnjë anëtar të këshillave të vendvotimit në komunat e Klinës, Istogut, Lipjanit, Fushë-Kosovës, Gjilanit dhe Kamenicës, edhe pse në zgjedhjet parlamentare kemi pasur 146 vota në Klinë, 213 në Istog, 369 në Lipjan, 314 në Fushë Kosovë, 1145 në Gjilan dhe 969 vota në Kamenicë. Përbërja e ekipeve në qendrat komunale të numërimit është gjithashtu në dëm të subjektit tonë politik, veçanërisht në dhjetë komuna me shumicë serbe, Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku, Leposaviqi, Graçanica, Shtërpce, Klllokoti, Parteshi, Novobërda dhe Ranillugu. Sipas parashtruesit të ankesës me vendime të tilla, subjekti politik Lista Serbe diskriminohet edhe në raport me subjektet të tjera politike që përfaqësojnë komunitetin serb, konkretisht subjektin politik Liri, drejtësi dhe mbijetesa e Nenad Rashiqit, u diskriminua gjithashtu edhe në raport me subjektet politike që përfaqësonin komunitetin shqiptar. Ky vendim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, i cili parashihet: KQZ-ja kujdeset për të siguruar përfaqësim të drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, bazuar në: 2.1. Numër të ndryshëm të popullsisë brenda komunës; 2.2. numër të votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal. Parashtruesi i ankesës thekson se me vendime të tilla, bëhet një përpjekje për të kryer një inxhinieri zgjedhore me anë të së cilës tentohet të përjashtohen nga gara zgjedhore përfaqësuesit autentikë serbë, në mënyrë që personat që nuk kanë legjitimitet për të përfaqësuar komunitetin serb të vihen në një pozicion më të favorshëm, të paligjshëm dhe jo kushtetues për të përfaqësuar komunitetin serb ose për të menaxhuar kuvendin lokal ose komunën. Propozojnë që PZAP-i të marrë një vendim që do të shfuqizojë vendimet e paligjshme dhe jo kushtetuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ta miratojë ankesën si të bazuar, të konfirmojë se Vendimi nr. 01-2349/2025 i datës 06.09.2025, mbi miratimin e rekomandimit për përbërjen e ekipeve të numërimit në Qendrat Komunale për Numërim (QKN) është i paligjshëm, sepse është në kundërshtim me nenet 63, 64 dhe nenin 101 të Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, si dhe nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit, sepse vendimi bazohet në diskriminim etnik të komunitetit serb dhe veçanërisht të subjektit politik Lista Serbe. Të konfirmojë se Vendimi nr. 01-2348/2025 i KQZ-së, datë 6 shtator 2025, mbi miratimin e rekomandimit për përbërjen e këshillave të vendvotimit, të rregullta dhe me kusht, është i paligjshëm sepse është në kundërshtim me nenet 63 dhe 64 paragrafi 2.10, nenin 77, nenin 75, nenin 76, nenin 77 dhe nenin 78 të Ligjit nr. 08/L-228 për

zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, si dhe nenin 5 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore nr. 10/2024 të Këshillave të Vendvotimeve, sepse vendimi bazohet në diskriminim etnik të komunitetit serb dhe veçanërisht të subjektit politik Lista Serbe. Të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të marrë një Vendim për miratimin e përbërjes së ekipeve të Numërimit në Qendrat e Numërimit Komunal (QNV) dhe Vendimin për miratimin e përbërjes së Këshillave të vendvotimit në qendrat e votimit të rregullta dhe me kusht, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 11/2024 për komisionet e votimit.

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në Ligjin nr. 08/1-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka emëruar "Përbërjen e Këshillit të Vendvotimit (KW). Kriteret të cilat janë marrë në përcaktimin e përbërjes së këtij trupi menaxhues zgjedhor është e bazuar në Rregulloren Zgjedhore nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve nenin 3 si kriter parësor: Subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale kanë të drejtë të përfaqësohen me nga një anëtar në KVV, Kandidati i pavarur i zgjedhur Kryetar Komune në zgjedhjet e fundit, në rast se garon sërish, ka të drejtë të përfaqësohet me një anëtar në KVV, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), sipas nevojës, mund ta rrisë ose ta zvogëlojë numrin e anëtarëve të KW-së deri në dy (2) anëtarë në KVV, KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ). Edhe në rasti kur kjo është realizuar KQZ ka vazhduar duke marrë për bazë kriteret tjera: KQZ, në bazë të formulës përkatëse, përfshin edhe subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, duke u bazuar në përqindjen e votave të fituara. Nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara në zgjedhjet që planifikohen të mbahen (12 Tetori). KKZ ka të drejtë t'i rekomandojë KQZ-së për nominimin e personave me përvojë në proceset zgjedhore, në rast se numri i anëtarëve të KVV-së nuk plotësohet. Me qëllim të rritjes së efikasitetit operacional dhe garantimit të një procesi zgjedhor të rregullt dhe të besueshëm përbërja e një Këshilli të Vendvotimit (KW) bazohet në strukturën standarde dhe orientuese prej pesë (5) anëtarëve, si në vijim: Kryesuesi i KVV-së — Udhëheq dhe mbikëqyr të gjitha aktivitetet në vendvotim; Kontrolluesi i rreshtit - Mban rreshtin e votuesve dhe vendos lapsin matrikulues në gishtin e votuesit. Zyrtari i identifikimit - Përgjegjës për verifikimin e identitetit të votuesve; Zyrtari i të dhënave statistikore - Regjistron të dhënat lidhur me pjesëmarrjen dhe raportimet teknike; Dhënësi i fletëvotimit — Shpërndan fletëvotimet. Me përjashtim të Komunës së Prizrenit, Mitrovicës së Veriut dhe Graçanicës, të cilat për shkak të numrit të madh të komuniteteve KQZ ka paraparë nga gjashtë (6) anëtarë në Këshillat e Vendvotimit. Në komunat Partesh dhe Ranillug, për shkak të numrit të kufizuar të subjekteve politike të certifikuara për zgjedhjet lokale, vendet e mbetura vakante në Këshillat e Vendvotimit është paraparë të plotësohen nga zyrtarët e administratës së komunave përkatëse. Duke marrë për bazë këto elemente katër (4) subjektet politike parlamentare që kanë kaluar pragun zgjedhor ju takon përfshirja në të gjitha KW-të. Subjektet Politike, nismat, kandidatët e pavarur që nuk kanë kaluar pragun zgjedhor për Kuvendin e Republikës së Kosovës përfaqësohen në KVV duke marrë parasysh përqindjen e popullsisë në atë komunë dhe rezultatet e fundit në zgjedhjet lokale. Në rastin konkret subjekti politik Lista Serbe në komunat Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok, nuk ka

marrë pjesë në zgjedhjet për Kryetar Komune ndërsa, po ashtu e njëjta nuk ka marr pjesë për zgjedhje për kuvend të komunës në Leposaviq dhe Zveçan. Komuniteti serb përfaqësohet me pesë (5) subjekte politike, dy (2) kandidat të pavarur dhe gjatë (6) iniciativa qytetare. Përfaqësimi i komuniteti Serb shtrihet në 18 komuna me gjithsej 404 anëtar në Këshillat e Vendvotimit, 47 kryesues, 319 anëtar dhe 38 rezerva. Përkundër faktit që subjekti politik Lista Serbe ka bojkotuar zgjedhjet lokal të jashtëzakonshme të vitit 2023 i është dhënë përfaqësim nga KQZ në 18 komuna me gjithsej 26 kryesues, 150 anëtar dhe 23 rezerva (gjithsej 199) anëtar në këshillat e vendvotimeve, përkundër faktit që ky subjekt politik është certifikua për zgjedhje lokale për kryetar komune (11) ndërsa për kuvend të komunës 18 komuna. Za Slobodu Pravdu i Opstanak është përfaqësuar në 6 komuna me gjithsej 19 kryesues, 80 anëtar dhe 10 rezerva (109) anëtar në këshillat e vendvotimeve. Srpska Demokratija është e përfaqësuar në 5 komuna - me gjithsej 26 anëtar dhe 1 rezerva (27) anëtar në këshillat e vendvotimeve. Kosovski Savez është e përfaqësuar në 5 komuna - me gjithsej 16 anëtar dhe 1 rezerva (17) anëtar në këshillat e vendvotimeve. Komuniteti serb është i përfaqësuar në Ekipeve të Numërimit në QKN në 10 komuna, me gjithsej 116 anëtar të ekipeve të numërimit ku 23 janë kryesues dhe 93 anëtar. Lista Serbe ka gjithsej 64 anëtar në ekipet e numërimit, 13 kryesues dhe 51 anëtar. Za Slobodu Pravdu i Opstanak ka gjithsej 42 anëtar në ekipet e numërimit, 8 kryesues 34 anëtar. Ujedinjenje ka gjithsej 6 anëtar në ekipet e numërimit, 1 kryesues 5 anëtar. Kosovski Savez ka gjithsej 4 anëtar në ekipet e numërimit, 1 kryesues 3 anëtar. Pretendimi se ka diskriminim të etnitetit serb nuk qëndron pasi që janë komuniteti i dyte me numrin më të madh të përfaqësuar në KW, po ashtu komuniteti i dyte me numrin më të madh të përfaqësuar në ekipet e numërimit në QKN. Elementi i barazisë vlen për gjitha komunitet në Republikën e Kosovës përfshirë edhe komunitet shumicë. Kjo përbërje reflekton praktikën më të mirë për menaxhimin e një vendvotimi si dhe e njëjta vlen edhe të ekipet e numërimit në QKN që siguron ndarje të qartë të përgjegjësisë, transparencë dhe rrjedhë të qetë të procesit zgjedhor. Pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë për arsyet e lartë cekura dhe kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që duke marrë parasysh faktet dhe argumentet e paraqitura, të refuzojë ankesën si të pabazuar. Bashkangjitur përgjigjes gjeni listën me anëtarët e KVV-ve, Ekipeve të Numërimit në QKN të miratuar nga KQZ, Vendimin përkatës, si dhe tabelën e përfaqësimit të komunitetit serb në këto dy mekanizma. Po ashtu, bashkangjitur gjeni raportin e fundit të Agjencisë të Statistikave të Kosovës (ASK), për regjistrimin e popullsisë, në të cilin jemi bazuar për këtë përfaqësim.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

**- Ankesa është e pabazuar.**

Sipas vlerësimit të Panelit pretendimet ankimore të parashtresës së ankesës se vendimet e KQZ-së, me nr. protokoli 01/2348/2025, të datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, dhe kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. protokoli 01/2349/2025, për Miratimin e Rekomandimit të Përbërjes së Ekipeve të Numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit, të

datës 06.09.2025, lidhur me mos emërimin e drejtë të anëtarëve të tyre nga radhët e subjektit politik Lista Serbe janë të pa bazuara.

Neni 77 paragrafi 5 i ligjit Nr.08/L-228, ku parashihet që *"Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin kryesuesit dhe anëtarëve të vendvotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të paraqesin ankesë në PZAP, brenda 48 orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ.*

Me dispozitën e nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashihet që: *"Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë".* Ndërsa paragrafi 4, i po të njëjtit nen parasheh që: *"Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve, të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni".*

Me dispozitën e nenit 20 paragrafi 1 i Rregullores Zgjedhore 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit parasheh që: *"KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse".* Paragrafi 2 i Rregullores parasheh që: *"Kryesuesit e ekipeve të numërimit, zgjedhën në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale".* Ndërsa paragrafi 4 i kësaj rregullore parasheh që: *"Procedura e nominimit dhe emërimit të ekipeve të numërimit bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve".* Ndërsa në nenin 3 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve parashihet që: *"KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV, për të gjitha komunitetet, duke u bazuar në: 2.1. Numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune; 2.2. numrin e votave të subjekteve politike të secilit komunitet, në nivel vendi dhe në nivel komunal".*

Andaj bazuar në dispozitat e sipërcituara ligjore Paneli ka gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se, me rastin e marrjes së vendimeve nga KQZ, nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 77 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullorja Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit si dhe Rregullorja Zgjedhore Nr.11/2024 për Këshillat e Vendvotimeve. Kjo për faktin se me rastin e përcaktimit të numrit të ekipeve të numërimit ka zbatuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi krejt duke marrë parasysh rezultatet zgjedhore të fundit dhe renditjes së subjekteve politike, përfshirë edhe subjektin politik ankues. Kjo pasi që subjektit politik Lista Serbe i është dhënë përfaqësim nga ana e KQZ në 18 Komuna me gjithsej 199 anëtarë në Këshillat e Votimit, prej tyre 26 kryesues, 150 anëtar dhe 23 rezerva.

Ndërsa pretendimet rreth përbërjes së ekipeve në qendrat komunale të numërimit se janë në dëm të subjektit politik Lista Serbe, veçanërisht në dhjetë komuna me shumicë serbe, Mitrovica e

Veriut, Zveçani, Zubin Potoku, Leposaviqi, Graçanica, Shtërpce, Kllokoti, Parteshi, Novobërda dhe Ranillugu, edhe këto pretendime janë të pabazuara, pasi që e njëjta nuk ka ofruar asnjë dëshmi për këto pretendime, por në mënyrë sipërfaqësore pa e provuar me ndonjë provë konkrete se si është bërë shkelja në këto raste.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të sipërcituara, pasi që subjekti politik Lista Serbe është i përfaqësuar në KVV në pajtim me këto dispozita dhe në bazë të Formulës për emërimin e KVV-ve, si dhe duke u bazuar në kriteret Rezultatet e Zgjedhjeve të fundit në nivel komunal, e po ashtu edhe të dhënat nga raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga Regjistrimi i Popullsisë 2024. Gjithashtu nuk qëndron edhe pretendimi për diskriminimin e komunitetit serb, kjo pasi që KQZ ka vepruar drejtë lidhur me përfaqësimin e komuniteteve, pasi që përfaqësimi i komunitetit serb është shtrirë në 18 komuna, me gjithsej 404 anëtarë në Këshillat e Vendvotimit, prej tyre 47 kryesues, 319 anëtarë dhe 38 rezerva, duke marrë për bazë se në nenin 3 par.1 të Rregullores 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve ndër të tjera thuhet se *“...se KQZ kujdeset që të sigurojë përfaqësimin e drejtë në KVV për të gjitha komunitetet duke u bazuar në numrin e dallueshëm të popullatës brenda një komune dhe numrin e votave të secilit komunitet në nivel vendi dhe në nivel komunal”*.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me përfaqësimin e subjekteve politike tek i njëjti komunitet, Paneli vlerëson se sipas dispozitave ligjore në fuqi nuk është obligative që numri i anëtarëve në KVV, të jetë i njëjtë për subjektet politike që vijnë nga radha e komuniteteve.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Janë vlerësuar edhe pretendime tjera ankimore të parashtuesit të ankuesit, por paneli nuk ka gjetur se nga vendimet e atakuara janë përfshirë me ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Prandaj, nga arsyet e parashtuara më lart bazuar në nenin 117.3 dhe 119.3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
ZL. A.nr.18/2025, datë 10.09.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.